



Flash Zjarri në Krujë, Ministri Lamallari: Policia ka arrestuar autorin e zjarrvënies së qëllimshme

POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

- 1

Marrëveshje ose dorëzim të plotë? Donald Trump paralajmëron se bllokada detare ndaj Iranit do të vazhdojë
- 2

70 ditë protestë/ Thirrje nga sheshi pas tërheqjes së Kullurit: Ata që kanë hatërmbetje, ejani të flasin! Refuzojnë 'Besën' e Ramës
- 3

çmimi i naftës në Azi
- 4

Trump njoftoi rifillimin e negociatave me Iranin, bie me 4%
- 5

Teherani rrëzon një dron amerikan në Ngushticën e Hormuzit
- Dhëntë e dhitë e Zeres, nami i Hasan Qeres

Kronikë

Tritol në banesën e 72-vjeçarit në Tufinë, shpallen në kërkim 3 vëllezërit! Nuk i bënë mobilet djalit të të moshuarit

Një borxh për mobijle dyshohet se fshihet pas tritolit në banesën e 72-vjeçarit në Tufinë. Djali i tij kishte porositur mobijle në biznesin e tre vëllezërve Alla, por nuk kishte shlyer pagesën. Të shpallurit në kërkim dyshohet se e kishin kërcënuar prej ditësh.



Sokol Dema
8 Gusht, 14:46 | Përditësimi: 8 Gusht, 15:25


Share Post WhatsApp

A A

TIRANË- Një shpërthim me **tritol** në derën e banesës së një 72-vjeçari në Tufinë të Tiranës ka vënë në kërkim nga Komisariati nr. 4, tre vëllezër, të gjithë me precedentë të mëparshëm penalë.

Ervis, Altin dhe **Maksim Alla**, 39, 43 dhe 41 vjeç, dyshohet se rreth orës 00:30 të 8 gushtit vendosën lëndën plasëse në hyrje të banesës. Shpërthimi shkaktoi vetëm dëme të vogla materiale, ndërsa fatmirësisht nuk pati persona të lënduar.

Sipas hetimeve paraprake, pista kryesore lidhet me një konflikt porosie mobijlesh. Tre vëllezërit Alla kanë një mobileri në Fushë-Krujë, ndërsa djali i 72-vjeçarit dyshohet se kishte porositur më herët disa mobijle, ka dhënë edhe kapar për ta por ata nuk i kanë mbaruar porositë. Prej disa ditësh, vëllezërit dyshohet se e kishin kërcënuar të riun derisa këtë të shtrunë në derën e banesës së babait të tij vendosën sasinë me tritol.



[Sh].com

LEXO EDHE:

70 ditë protestë/ Thirrje nga sheshi pas tërheqjes së Kullurit: Ata që kanë hatërmbetje, ejani të flasin! Refuzojnë 'Besën' e Ramës

Vëllezërit, me precedent për mashtrim dhe kanosje, udhëtuan me 1 automjet drejt Tufinës, kanë vendosur lëndën plasëse dhe më pas janë larguar. Hetuesit po analizojnë pamjet e kamerave të sigurisë, me qëllim identifikimin dhe gjurmimin e automjetit, ndërsa vijon puna për kapjen e tre personave të shpallur në kërkim.

“Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Nr. 4, menjëherë pas njoftimit se në lagjen “Tufinë”, në derën e banesës së shtetasit J. M., kishte shpërthyer një sasi lënde plasëse, duke shkaktuar dëme të pakta materiale, kanë organizuar operacionin policor “Motivi”, me qëllim zbardhjen e kësaj ngjarjeje, si dhe identifikimin dhe kapjen e autorëve.

Falë veprimeve të shpejta dhe profesionale hetimore, këqyrjes së vendit të ngjarjes, administrimit të provave, në kuadër të operacionit të koduar “Motivi”, u bë e mundur zbardhja e ngjarjes dhe identifikimi i autorëve të dyshuar. Në vijim të veprimeve procedurale për këtë rast, u shpallën në kërkim shtetasit E. A., 39 vjeç, A. A., 43 vjeç dhe M. A., 41 vjeç, të tre vëllezër, për veprën penale “Shkatërrimi i pronës me eksploziv”, kryer në bashkëpunim.

Nga tërësia e veprimeve hetimore, si dhe nga informacionet e siguruar në rrugë operative, dyshohet se shtetasit E. A., A. A. dhe M. A., më datë 08.08.2026, rreth orës 00:30, për motive të dobëta, kanë vendosur dhe shpërthyer një sasi lënde plasëse në derën e banesës së shtetasit J. M., duke shkaktuar dëme të pakta materiale”, njofton Policia.

Sqarim: Çdo person prezumohet i pafajshëm deri sa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë

SI.E./Shqiptarja.com

TAG: Tirane tritol altin alla Ervis Alla Maksim Alla

Komente Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:

GJKKO kërkon të kufizojë aksesin e mediave dhe të drejtave të gazetarëve gjatë seancave, a jeni dakord?

Po Jo Nuk e di

5 Gusht, 13:27

Lajme të tjera



69 ditë protestë para kryeministrisë, protestuesit: Kemi kapur mat Berishën e Ramën, Belinda në burg! Sjellin bluzën me premtimin ‘derisa dorëheqja të na ndajë’

7 Gusht, 20:30



'Mendoi se mund t'i shpëtonte së kaluarës', Ambasada Amerikane tregon si u kap dhe ekstradua Sokol Hoxha pas 30 vitesh arrati: SHBA nuk është strehë për kriminelët

7 Gusht, 17:39



Tiranë/ 10-vjeçari përplaslet nga motori dhe makina! Pranga 27-vjeçarit, nën hetim 47-vjeçari

7 Gusht, 15:45



PD kërkon transparencë për Galerinë Kombëtare të Artit: Prej 5 vitesh e mbyllur, të publikohen kontratat dhe kostot e rikonstruksionit

7 Gusht, 14:51



Mashtroi dhe i mori para shqiptares duke i premtuar një ‘pako surprizë’, Prokuroria e Tiranës mbyll hetimet dhe dërgon për gjykim nigerianin


7 Gusht, 11:50



Vrasja e Edmond Sulës, kontrollë në 3 banesa! Shoqërohen për t'u marrë në pyetje disa persona

Sokol Dema


7 Gusht, 10:19



Ekstradohet nga Italia 'i forti i Bulqizës', Fadil Tërnova! Me rekorde kriminale, por kreu vetëm 3 vjet burg për vrasjen e një biznesmeni! A e 'përkëdhelën' gjykatat?

Sokol Dema

7 Gusht, 10:06



68 ditë në bulevard, protestuesit përsërisin kërkesat: Nuk largohemi pa ikur Rama! Akuza qeverise për situatën e zjarreve: Pylli s'ka vlerë para Kanye West

6 Gusht, 20:18



Grabitja e argjendarisë në Paskuqan, hetimet zbulojnë itinerarin e autorëve! Shmangën rrugët kryesore, morën floriri me vlerë mbi 1.5 mln lekë

Sokol Dema

6 Gusht, 11:04



67 ditë para kryeministrisë, protestuesit Ramës: Shijo pushimet e fundit në liri! Thirrje SPAK-ut për hetim ndaj shefit të qeverisë

5 Gusht, 20:15



E dënuar me 4 vite e 2 muaj burg në Stamboll për lidhje me terrorizmin, pranga aktivistes turke në Rinas! Ekstradohen 2 shqiptarë nga Mbretëria e Bashkuar e Athina (EMRAT)

5 Gusht, 15:16



Grabitet me kallash argjendaria në Paskuqan, 2 autorët arratisen me motor pa targa (VIDEO)

5 Gusht, 15:04



✕ [Sh].com

Lajmi i fundit



Zjarri në Krujë, arrestohet autori! Lamallari: Do të përballlet me pasojat ligjore! Janë evakuuar banorët në afërsi të vatrës

8 Gusht, 21:31

